



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Komiteti për Komunitete

Nr. 02-060/01-0035141-1/24 dt. 31.05.2024

Mitrovicë

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Komitetit për Komunitete
Seanca e 28-të

Koha: 31.05.2024 ora 15:00
Vendi: Salla e Mediave
Të pranishëm: Anëtarët e Komitetit për Komunitete: Jeton Rrahmani, Xhafer Preteni, Majlinda Kurti, Elidiana Budini Haziri, Xhevrije Bahtiri Ademi, Gazmend Asllani, Ardita Aliu, Agron Jashari, Esat Krasniqi dhe Habib Hajdini
Mungoi: Edina Sejdiu Hamzagic

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Kryesuesi i Komitetit i cili fillimisht përshëndeti të pranishmit dhe theksoi se në zbatim të nenit 51, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale; nenit 61, paragrafi 2, dhe nenit 62, të Statutit të Komunës; nenit 12, paragrafi 1, të Rregullores për punën e Kuvendit; nenit 14, paragrafi 3, të Rregullores për punën e komiteteve të Kuvendit; për sot kam thirrur mbledhjen e rregullt të Komitetit për Komunitete me këtë:

REND DITE:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Raporti i ZKKK për periudhën Janar-Mars 2024
3. Deponitë ilegale të mbeturinave në lagjen "Adem Voca"
4. Diskutim për hapësirat e Qendrës Mësimore RADC

Rendi i ditës u miratua unanimisht

Pika 1

Procesverbali nga mbledhja e kaluar u miratua unanimitisht.

Pika 2

Kryesuesi i Komitetit z. Jeton Rrahmani sa i përket Raportit të punës së ZKKK-së për periudhën Janar-Mars 2024 fjalën për ta sqaruar ia kaloi znj. Snezhana Nestorovic.

Snezhana Nestorovic në pika të shkurta e arsyetoi Raportin e punës së ZKK-së për periudhën Janar-Mars 2024.

Anëtarët e Komiteti për Komunitete unanimitisht e miratuan Raporti i punës së ZKKK-së për periudhën Janar-Mars 2024.

Pika 3

Kryesuesi i Komitetit z. Jeton Rrahmani sa i përket Deponive ilegale të mbeturinave në lagjen "Adem Voca", jemi të informuar nga qytetarët por edhe nga vizitat që i kemi bërë në si komitet e kemi pa se ka mjaft probleme në atë lagje por më shqetësuese është mos marrja e mbeturinave në lagjen Adem Voca, pra ne nuk e dimë arsyen se pse nuk pastrohet ajo pjesë a është arsyeja pagesa apo çka, andaj ne si Komitet u dakorduam që ta ftojme në mbledhjen e radhës në takim me Drejtorin e ambientit z. Egzon Sadiku dhe drejtorin e KRM "Uniteti" (me fokus vazhdimi i pastrimit dhe mbledhja në mënyrë të rregullt dhe periodike në lagjen Adem Voca).

Pika 4

Kryesuesi i Komitetit z. Jeton Rrahmani lidhur me Diskutimin për hapësirat e Qendrës Mësimore RADC ne si Komitet bashkërisht u dakorduam që të drejtohem Kryetarit të Komunës me një Rekomandim.

Kryesuesi i Komitetit z. Jeton Rrahmani atëherë hedh në votim Rekomandimin:

Komiteti për Komunitete i Rekomandon Kryetarit të Komunës që të bëjë rishqyrtimin e marrëveshjes për shfrytëzimin të objekteve nga OJQ-të në qendrën mësimore RADC, për shkak se organizatave të cilat operojnë në atë objekt iu ka skaduar kontrata.

Komiteti për Komunitete miratoj unanimitisht Rekomandimin e propozuar.

Mbledhja përfundoj punimet në ora 15:45 min.

Mitrovicë
31.05.2024

Procesmbajtës:

Afërdita MAXHUNI

Kryesuesi i Komitetit

Jeton RRAHMANI